

## KONTRATE HUAJE

Date .....

Kjo kontrate u hartua ne përputhje me nenin 6, 420, 1050, 1051, 1052, 1053, 1054 dhe 1055 te Kodit Civil .

### PALET

Kjo kontrate lidhet ndermjet:

a) Huadhenesi , Emer atesi mbiemer i dtl..... lindur ne ..... e banuese ne .....,.....  
Nr. Dokumenti identifikimi .... leshuar me date ...

b) Huamarresi – Emer atesi mbiemer i dtl..... lindur ne ..... e banuese ne .....,.....  
Nr. Dokumenti identifikimi ... leshuar me date ...

d) (Nese ka ) Dorezanesi –.... Emer atesi mbiemer i dtl..... lindur ne ..... e banuese ne .....,.....  
Nr. Dokumenti identifikimi ... leshuar me date ...

### OBJEKTI

Huadhenesi i jep Huamarresit nje Huaje , shume e se ciles eshte ..... ne perputhje me kushtet e parashikuara ne kete kontrate.

Huaja do te kete nje kohezgjatje prej ....(.....) muajsh dhe do kete nje plan shlyerje ..... cdo date ... te muajit.

### KRITERET PER LEVRIMIN DHE SHLYERJA E HUASE

Huaja jepet/levrohet/disbursohet ne daten ..... dhe nese ka ne llogarine bankare me numer ...

Afati kohor per shlyerjen perfundimtare te huase do te jete ..... Pas perfundimit te ketij afati kohor dhe shlyerjes totale te shumes (duke perfshirjes ketu edhe interesat) detyrimi i huamarresit do te shuhet.

Ne qoftese Huaja do te shlyhet përpara datës se përcaktuar, kjo do te konsiderohet si data finale e shlyerjes se Huase.

Ne rast kur pagesat e Huamarrësit nuk mbulojnë detyrimet baze te kësaj kontrate , atëherë detyrimet e Huajemarresit do te shlyhen sipas rradhes se mëposhtme :1.kushti penal;2.interesi;3.principali , perjashtuar kur palet jane marre vesh ndryshe.

### INTERESI

Për Huane , Huamarrësi i paguan **Huadhënësit interes me baze vjetore ... % (...)** te pandryshuar gjate gjithë kohëzgjatjes se Huase.

Interesi i detyruar nga Huamarrësi paguhet ne mënyrë periodike sipas shume te pagesave te interesit te përcaktuara ne këtë kontrate.

Huadhenesi do te marre çdo dite interesin e detyruar mbi pjesën e pashlyer te Huase. Interesi real i detyruar përlogaritet ne baze te interesit real te detyruar mbi pjesën e pashlyer te Huase.

**E shprehur ne shume parash nga Huamarrësi do ti paguhet Huadhënësit një shume prej ..... ne Lek/Euro/Dollar . Interesi llogaritet nga data e dhënies se Huase.**

Për te gjitha veprimet dhe transaksionet e kryera ne baze te kësaj kontrate ,palët bien dakord qe interesat përkatëse dhe shumat e tjera te detyrueshme për Huamarrësin do te llogariten ne baze te ditëve efektive , duke pranuar vitin me 360 dite.

### **PENALITETE**

Pagesat e detyrueshme te pashlyera ne afat per shkak te mospageses ne kohe te kestit , kalojne ne pagesa me kamate vonese , mbi te cilat aplikohet interesi mbi pjesën e pashlyer te Huase dhe nje penalitet me një shume prej .....

### **KOLATERALI**

Me qëllim garantimin e shlyerjes se detyrimit ne kohe ,Huamarrësi jep ne favor te Huadhënësit deri ne momentin e përmbushjes se detyrimit : (Te dhënat e detajuara te sakta te sendit )

Huamarrësi duhet :

a)te mos kryeje , si dhe te mos lejoje kryerjen e çdo lloj veprimi administrativ, regjistroje te drejta pronësie ose te vere barra administrative mbi këtë send, pa miratimin paraprak me shkrim te huadhënësit:

Duhet te mbaje sendin ne gjendje te mire për qëllimet e kësaj Kontrate duke kryer te gjitha riparimet e nevojshme, si edhe te paguaje te gjitha detyrimet tatimore , taksa dhe shpenzime për pronën e tij;

Te mos kryeje ,si dhe te mos lejoje kryerjen e çdo veprimi , i cili do te kufizojte te drejtat e Huamarrësit apo Huadhënësit , si dhe mund te ule vlerën e pasurisë ,objekt i kësaj kontrate;

Ne rastin e shitjes se pasurisë se paluajtshme nëpërmjet ankandit, ne përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar , Huamarrësi japin miratimin e tij te përvokueshëm dhe te pakushtëzuar se shitja nëpërmjet ankandit e sendit do te filloje me çmimin fillestar te barabarte me çmimin e vlerësimit te kryer duke llogaritur interesi mbi pjesën e pashlyer te Huase, penalitetet dhe pjesa e pashlyer e huase.

## **LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE**

Për ceshtjet e paparashikuara ne këtë kontrate , do te zbatohen aktet normative ne fushën Huadhënies, si dhe aktet normative te legjislacionit shqiptar ne fuqi .

Te gjitha mosmarrëveshjet e lindura midis palëve ne lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj kontrate zgjidhen me mirëkuptim midis tyre. Ne rast te kundërt , zgjidhja e mosmarrëveshjeve do te kryhet ne rruge gjyqësore pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor ..... .

Palët e lexuan dhe e miratuan tekstin e kësaj kontrate, pranojnë se ky eshte vullneti i tyre, e nënshkruajnë këtë kontrate rregullisht sipas ligjeve te Republikës se Shqipërisë.

**HUAJEDHENESI**

**HUAMARRESI**

**DOREZANESI**